



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-002

Prishtinë, më 22 shkurt 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 22 SHKURT 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha dhe Sherif Konjufca;

Nga ZCN: Blerta Bejtullahu, dhe

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e :

1. Shqyrtimin e kërkesës së Grupit të deputetëve të Kuvendit për seancë të jashtëzakonshme, me 22 shkurt 2011

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me përmbajtjen e kërkesës së Grupit prej 50 deputetëve të Kuvendit, që kishin parashtruar kërkesë për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit më 22 shkurt 2011, në orën 15:00, me këtë rend dite:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe
2. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryetari tha se kërkesa e cekur më lart është në përputhje me rregullat procedurale për punën e Kuvendit dhe hapi diskutimin lidhur me të.

Lidhur me kërkesën e grupit prej 50 deputetëve të Kuvendit për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, diskutuan: Xhavit Haliti, Glauk Konjufca, Sabri Hamiti, Petar Miletqi dhe Enis Kervan. Diskutimet e plota janë dhënë në Transkript.

Kryesia caktoi edhe kohën e diskutimit në seancë, si vijon: kryetarët e grupeve deri 10 minuta, ndërsa deputetët 5 minuta.

Kryesia, njëzëri vendosi që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 22 shkurt 2011, në orën 15:00, me këtë

R e n d d i t e :

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës,
2. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale